

VENDIM
Nr. 15, datë 19.1.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË
SHOQËRISË “KOMP ENERGJI” SHPK, ME NUMËR 253, SERIA T14P, MIRATUAR
ME VENDIMIN E BORDIT NR. 102, DATË 7.11.2014,
“PËR TREGTIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të neneve 16; 20, germa “b”; dhe 43, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”; VKM-së nr. 840, datë 11.6.2008 “Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Vinjoll”; neneve 10 dhe 15 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 109, datë 29.6.2016, të Bordit të ERE-s; nenit 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.1.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, në lidhje me modifikimin e licencës së aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Komp Energji” sh.p.k.,

konstatoi se:

- Shoqëria “Komp Energji” sh.p.k. është licencuar në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 30-vjeçar, me licencën numër 253, seria T14P, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.102, datë 7.11.2014.

- Referuar shkresës nr. 791 prot., datë 11.11.2016, të nënshkruar nga administratori i koncensionarit “Komp Energji” sh.p.k. dhe administratori i shoqërisë koncesionare “Hidropowerplant Construction” sh.p.k. është kërkuar zëvendësimi i emrit të koncensionarit “Komp Energji” sh.p.k., me emrin e shoqërisë koncesionare “Hidropowerplant Construction” sh.p.k., vetëm për licencën e prodhimit të energjisë elektrike.

- Meqenëse licenca e tregtimit të energjisë elektrike është e lidhur kryesisht me aktivitetin e prodhimit të HEC-ve “Hurdhas 1”, “Hurdhas 2” dhe “Hurdhas 3”, është e nevojshme të bëhet edhe modifikimi i licencës të tregtimit të energjisë elektrike në favor të shoqërisë koncesionare “Hidropowerplant Construction” sh.p.k.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës me numër 253, seria T14P, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 102, datë 7.11.2014, për tregtimin e energjisë elektrike, të mbajtur nga koncesionari “Komp Energji” sh.p.k.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti